



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/01-4513

Dt. 10.03.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Petrit (Hamëz) Bellacerka** nga Gjakova, për dhënjen e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të banimit individual, me etazhitet P+1, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr.2003/14 nenit 17, si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

AKTVENDIM

I. I LEJOHET: aplikuesve: Petrit (Hamëz) Bellacerka nga Gjakova, ndërtimi i objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual, sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Rregullues Urban "Tirana", si dhe Kushtet Ndërtimore me nr. 07-351-49382, dt. 08.12.2016, të lëshuar nga DUMM, në ngastrën kadastrale me nr. 5057/10, Z.K. Gjakovë –J- Qytet, në rrugën "Petro Nini Luarasi", në pronësi të të lartëpërmendurit, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit është P+1, me sipërfaqe të përgjithëshme (bruto) të objektit **S=193.40 m²**.

Përdhesa: (Sip,Bruto): S= 67.40 m²
Kati i parë: (Sip,Bruto): S= 126.00 m²

II. Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objektit të banimit individual, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja projektuese shërbyese "HARP" N.P.SH. Gjakovë.

IV. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

V. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

VI. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Petrit (Hamëz) Bellacerka nga Gjakova, me banim në rrugën "Ali Pashë Tepelena", nr.120, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-4513 të datës 02.03.2017 për dhënjen e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual, me etazhitet P+1, në ngastrën kadastrale me nr. 5057/10, Z.K. Gjakovë –J- Qytet, në rrugën "Petro Nini Luarasi", siq është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 25.10.2016, të punuar nga NSH"Geogauss Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 28.02.2017 (fotokopje) në pronësi të Petrit (Dan) Bellacerka nga Gjakova, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikaten mbi të drejtën në pronën e paluajtshme (fotokopje) me nr.të lëndës 798/17, të datës 24.02.2017, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Kushtet Ndërtimore, me nr. 07-351-49382, të datës 08.12.2016, për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit të banimit individual, në ngastrën kadastrale me nr. 5057/10, ZK: Gjakovë – J- Qytet të lëshuar nga DUMM.
5. Pëlqimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, me nr.08-320/01-4418/17, dt.01.03.2017, nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
6. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr 430-a-998 të datës 24.02.2017.
7. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, të datës 22.12.2016.
8. Pëlqimin nga K.R.U."Radoniqi"Sh.A.Gjakovë, të datës 15.12.2017.
9. Pëlqimin nga PTK-Gjakovë, dt. 14.12.2016.
10. Vërtetimin nga KRM"ÇABRATI", me nr.167, 24.02.2017.
11. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Posten e Kosoves, filiala Gjakovë me datë 08.03.2017.
12. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, ndërmarrja projektuese shërbyese "HARP" N.P.SH. Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 918.37 Euro.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi,pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor në Prishtinë, dhe e njejta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.


Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspektionit,
- Arhivës.

Zyrtar i lartë për çështje juridike


Zenel Shabani,jur.dipl.

U. D. D r e j t o r i



Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark.

K.K. GJAKOVË

Zon. kad:Gj.j.Qytet

Parcela nr. 5057/10

PLAN SITUACIONI



LOKACIONI :
PETRIT BELLACERKA

Punoj:
Fatmir Bobi tek.gjeod.

Vërteton urb.
Mirlinda Mullahasani D.A.

693
350
454
650

Gjakovë;
23.11.2016

KOPJA E PLANIT

KUVENDI I KOMUNËS GJAKOVË
 DREJTORIA PËR GJEODEZI,
 KADASTËR E PRONË
 Zona Kadastrale : Gjakove-Jasht-Qytet
 Poseduesi : 1 /1 Bellacerka Petrit (Hamez)
 Nga Gjakova

Perpjesa: 1 : 500



Gjendja me datë :

Nr. i ngast.	Kultura	Klasa	Emërtimi i ngastrës	Sipërfaqja			Të ardh. kad.
				ha	ari	m?	
5057-10	ARE	5		0	03	67	
			Gjithesëjta:	0	03	67	

Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastrë duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.

Gjakovë, 28.02.2017

VËRTETON: *Bashkim Rudi*

B. Rudi